



PULSAR

Seminari V i Komuniteti të Praktikës për Raportimin Financiar (KPRF)

Vjenë, Austri, 21-22 nëntor 2019

Përvoja ndërkombëtare në zbatimin e sistemit IFMIS në Amerikën Latine




CFRR >>
Centre for Financial
Reporting Reform



Public Sector Accounting and Reporting Program

CO-FUNDED BY

 Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

Të përgjithshme që duhen pasur parasysh



2

Nuk ka një projekt PERFECT për zbatimin e sistemit IFMIS.

Të gjitha projektet kanë përvoja TË SUKSESSHME dhe DËSHTIME, të cilat ia vlen të kuptohen dhe analizohen si MËSIME TË NXJERRA.

Ky prezantim nuk fokusohet vetëm në PRAKTIKAT MË TË MIRA apo PËRVOJAT E SUKSESSHME, ky prezantim fokusohet në MËSIMET E NXJERRA nga PËRVOJAT E SUKSESSHME DHE DËSHTIMET.

1. Zgjidhjet praktike – Fokusi te çfarë dhe jo te si



3

- Specifikimet teknike:
 - Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Thesarit: Kolumbia. (Rreth 40 përdorues, buxheti fillestar 3 milion US\$).
 - Projekt shumë i plotë. (1,5 vjet)
 - Specialisti funksional zhvillon specifikime TË HOLLËSISHME por PRESKRIPTIVE.
 - NUK është bërë kërkim i tregut përpara proceseve të prokurimit.
 - Kërkesat qenë **TEPËR PRESKRIPTIVE**, është identifikuar një nivel i lartë përshtatjeje, propozimi më i ulët financiar qe 15 milion US\$ (pesëfish i buxhetit fillestar).



2. Qasja pragmatike për integrimin

- Integrimi midis ciklit të zbatimit të buxhetit dhe procesit të prokurimit: Kili
 - Projekti origjinal bazohej në **Integrimin e proceseve**.
 - Pas 2 vjetësh dhe pas disa orvatjesh për integrim, nuk u arrit **asnjë marrëveshje** për integrimin e proceseve.
 - Projekti iu kthye **objektivave**: i. Mbjajtja në kontroll e gatishmërisë së buxhetit; ii. Mbjajtja në kontroll e pagesave kundrejt vlerës së kontratës; dhe iii. Mbjajtja në kontroll e përfituesit përfundimtar kundrejt furnitorit fitues i kontratës.
 - Qasja e re orientohej drejt **KONFIRMIMIT** të informacionit nga Agjencia e Prokurimeve Publike.
 - Integrimi u vu në zbatim **4 muaj** pas qasjes së re.




3. Strategjia për raportimin dhe të dhënat historike



5

- Disa vende me model IFMIS të centralizuar kanë hasur në probleme të PERFORMANCËS për shkak të balancimit midis kërkesave për transaksionin & raportimin.

- Kolumbia: Kontabiliteti i centralizuar, Llogaria Unike e Thesarit, bazë unike të dhënash mbi transaksionet dhe raportimin. Pas 4 vjet operacionesh, duhej kaluar në qasjen me databazë të dyfishtë.
- Guatemala, Hondurasi, Nikaragua: Ende përballen me probleme të rënda të performancës. (Databaza unike është një prej arsyeve)
- Kili: Projektuar që në fillim si një databazë e dedikuar për raportimin.
- Data warehouse për raportimin mund të ishte një qasje e përshtatshme.



4. Zgjidhjet me efikasitet të kostos



6

- **Zvogëlimi i kostove të licencimit (Panamaja):**
 - Funkzionet **qendrore të sistemit IFMIS** në mbështetje të ciklit të shpenzimeve janë zbatuar duke përdorur SAP.
 - **Kostoja e licencimit** qe një problem i rëndësishëm për të siguruar qëndrueshmërinë financiare.
 - Ministria e Financave dëshironte të përfshinte në pjesën qendrore të IFMIS funksionet e **përgatitjes së buxhetit**. Ky është një funksion i **dekoncentruar**, më shumë se **900 përdorues të rinj**.
 - **Efikasiteti i kostos** së këtyre licencave të reja të nevojshme qe shumë i **ulët**. Vëllim i lartë por shumë pak transaksione për përdorues në vit (funksion i përkohshëm).
 - Qeveria zbatoi një **Portal të Përgatitjes së Buxhetit**, të lidhur me pjesën qendrore të IFMIS. Kostoja e licencimit ra në mënyrë drastike.
 - E njëjta qasje po i propozohet Filipineve.



5. Strategjia për menaxhimin e ndryshimit



7

- **Menaxhimi i ndryshimit është KYÇ.**
 - Menaxhimi i ndryshimit: Fitimi i mbështetësve për ndryshimin → Duan ta bëjnë; Dinë si duhet bërë; mund ta bëjnë.
 - Që nga **strukturimi** i Projektit. **Hondurasi**: Projekti dështoi për shkak të njohjes së pakët të punës së mëparshme dhe anëtarëve ekzistues të ekipit.
 - Gjatë fazës së **projektimit**. **Panamaja**. Palët e interesit nuk u përfshi që në fazën e projektimit. Disa palë interesi e perceptonin sistemin IFMIS si diçka që po u imponohej të cilën nuk donin ta merrnin në konsideratë. Probleme me pranimin dhe me drejtimin e brendshëm.
 - **Përcaktimi i pritjeve** dhe fazave. **Brazili**. Qeveria vendosi afate për vënien në zbatim të SKNSP-ve nën nivelin e qeverisjes qendrore sipas qasjes universale. Nuk qe e realizueshme, qasja dhe afatet janë ndryshuar disa herë. Kjo e **uli kredibilitetin** dhe interesin për zbatimin e SNKSP-ve.



6. Përfshirja e përfitimeve të shpejta



8

- **Përfitimet e shpejta ndihmojnë në ruajtjen e interesit për projektin**
 - **Banka Qendrore e Paraguit:** Projekti IFMIS gëzonte kredibilitet të ulët brenda institucionit. Strategjia ishte zbatimi i një produkti të thjeshtë por të dukshëm. Kërkesa e lejeve vjetore dhe lejeve të tjera në formë të vetëshërbimit.
 - **Kolumbia:** Portali i transparencës u vu në zbatim duke përdorur informacionet ekzistuese. Portali u prezantua nga Presidenti dhe u prit mirë nga shtypi dhe qytetarët.